

# Statistikat e Krimeve

## Tremujori i dytë 2018

**Tiranë, më 26 korrik 2018:** Në tremujorin e dytë 2018, janë evidentuar gjithsej 8.484 vepra penale, duke shënuar një rritje me 1,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2017.

Numri i grupveprës vrasje me dashje të evidentuara, në tremujorin e dytë 2018, është 13, 6 vrasje më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për grupveprën penale vrasje mbetur në tentativë, në këtë periudhë janë evidentuar 36 vepra, 1 më shumë, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Numri i veprave penale të rënda kundër pasurisë, në këtë tremujor është 23, duke shënuar një rënie me 11 vepra, krahasuar me tremujorin e dytë 2017. Kjo grupvepër përfshin veprat penale vjedhje me dhunë, vjedhje me armë dhe vjedhje me pasojë vdekjen.

Në tremujorin e dytë 2018, janë evidentuar 31 krime me natyrë seksuale, 9 më shumë, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Nga këto, 8 prej tyre i përkasin veprës penale “Vepra të turpshme”.

Në tremujorin e dytë 2018 janë evidentuar 438 vepra penale në fushën e drogës, duke shënuar një rënie me 26,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Këtu përfshihen veprat prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike dhe trafikimi i narkotikëve.

Në këtë periudhë janë evidentuar 55 vjedhje të automjeteve, me një rënie prej 24,7 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Numri i veprave penale të evidentuara për vjedhje lokale tregtie, në tremujorin e dytë 2018, është 144, duke shënuar një rritje me 16,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i veprave penale të evidentuara për vjedhje banese, në tremujorin e dytë 2018, është 304, duke shënuar një rritje me 14,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në këtë periudhë janë evidentuar 22 vjedhje duke shpërdoruar detyrën, 7 vjedhje më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të 2017.

Numri i veprave penale të evidentuara për vjedhje mbetur në tentativë, në tremujorin e dytë 2018, është 96, duke shënuar një rënie me 23,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i veprës penale shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, në tremujorin e dytë 2018 është 570, 12 vepra më shumë të evidentuara, krahasuar më të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab. 1 Vepra penale të evidentuara**

Vepra penale	T1 - 2017	T2 - 2017	T3 - 2017	T4 - 2017	T1 - 2018	T2-2018	Ndryshimi në % (T2-2017 - T2-2018)
Vrasje me dashje	8	19	13	10	12	13	-31,6
Vrasje mbetur në tentativë	33	35	39	22	25	36	2,9
Vepra penale të rënda kundër pasurisë	52	34	36	42	33	23	-32,4
Krime seksuale	29	22	41	21	13	31	40,9
Krime në fushën e drogës	458	595	613	454	428	438	-26,4
Vjedhje automjete	86	73	102	68	58	55	-24,7
Vjedhje lokale tregtie	146	124	89	133	182	144	16,1
Vjedhje banese	300	266	279	300	307	304	14,3
Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	30	29	29	30	20	22	-24,1
Vjedhje mbetur në tentativë	109	125	90	93	99	96	-23,2
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	406	558	685	598	473	570	2,2
Vepra penale të tjera	5.838	6.513	7.935	6.707	6.259	6.752	3,7
<b>Gjithsej</b>	<b>7.495</b>	<b>8.393</b>	<b>9.951</b>	<b>8.478</b>	<b>7.909</b>	<b>8.484</b>	<b>1,1</b>

### Autorët e veprave penale

Në tremujorin e dytë 2018, janë evidentuar gjithsej 8.131 autorë të veprave penale, duke shënuar një rritje me 3,5 % krahasuar me tremujorin e dytë 2017.

Numri i autorëve për grupveprën vrasje me dashje, në këtë tremujor është 12, 5 autorë më pak të evidentuar, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë numërohen 45 autorë të evidentuar për grupveprën vrasje mbetur në tentativë, 6 autorë më shumë, krahasuar me tremujorin e dytë 2017.

Numri i autorëve për vepra penale të rënda kundër pasurisë, në tremujorin e dytë 2018, është 31, 2 autorë më pak, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2017.

Në këtë periudhë janë evidentuar 33 autorë për grupveprën krime me natyrë seksuale, duke shënuar një rritje me 13 autorë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i autorëve për krime në fushën e drogës, në tremujorin e dytë 2018, është 528, duke shënuar një rënie me 24,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për veprën vjedhje e automjeteve, në këtë tremujor janë evidentuar 6 autorë, 10 autorë më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Në tremujorin e dytë 2018, janë evidentuar 122 autorë për veprën vjedhje lokale tregtie, 42 autorë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i autorëve për vjedhje banese, në tremujorin e parë 2018 është 146, duke shënuar një rënie me 11,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për veprën vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën, në këtë tremujor janë evidentuar 25 autorë, 9 autorë më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Në tremujorin e dytë 2018, janë evidentuar 88 autorë për veprën vjedhje mbetur në tentativë, 1 autor më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i autorëve për veprën shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, në tremujorin e dytë 2018, është 563, duke shënuar një rritje me 1,8 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

**Tab. 2 Autorë të veprave penale**

Vepra penale	T1 - 2017	T2 - 2017	T3 - 2017	T4 - 2017	T1 - 2018	T2-2018	Ndryshimi në % (T2-2017 - T2-2018)
Vrasje me dashje	6	17	15	10	19	12	-29,4
Vrasje mbetur në tentativë	38	39	55	24	38	45	15,4
Vepra penale të rënda kundër pasurisë	71	33	46	42	29	31	-6,1
Krime seksuale	30	20	37	24	13	33	65,0
Krime në fushën e drogës	591	702	674	574	514	528	-24,8
Vjedhje automjete	16	16	102	23	13	6	-62,5
Vjedhje lokale tregtie	114	80	117	70	151	122	52,5
Vjedhje banese	159	164	184	121	155	146	-11,0
Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën	33	34	34	29	20	25	-26,5
Vjedhje mbetur në tentativë	86	89	75	62	73	88	-1,1
Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor	391	553	687	581	453	563	1,8
Vepra penale të tjera	5.477	6.112	7.648	6.179	5.949	6.532	6,9
<b>Gjithsej</b>	<b>7.012</b>	<b>7.859</b>	<b>9.674</b>	<b>7.739</b>	<b>7.427</b>	<b>8.131</b>	<b>3,5</b>

# Metodologjia

Statistikat e krimeve pasqyrojnë të dhëna mbi veprat penale të evidentuara dhe personat e dyshuar si autorë në kryerjen e një vepre penale.

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, jo në gjykime përfundimtare, të cilat janë në kompetencat e organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin.

## **Përkufizime:**

**Vepra penale:** Veprat me të cilat cenohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm, kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundërvajtje penale.

**Autorë:** Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejojnë që të ndodhë një vepër penale, pra shkaktojnë pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale, ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

**Vrasje me dashje:** Përfshin të gjitha ato vepra penale kundër jetës, të kryera me dashje si vrasje me dashje, vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, vrasje me paramendim , vrasje për gjakmarrje, vrasje në rethana tjera cilësuese, vrasja e funksionarëve publike, vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare dhe vrasje foshnjës.

**Vepra penale të rënda kundër pasurisë:** Përfshihen ato vepra që synojnë vjedhjen e një personi, duke përdorur dhunë apo forcë si vjedhje me dhunë, vjedhje me armë dhe vjedhje me pasojë vdekjeje.

**Krime seksuale:** Përfshihen ato vepra të kundërligjshme që ndikojnë në sferën e sigurisë së lirisë seksuale dhe të zhvillimit normal të formimit seksual, si marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç, marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura, marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike, dhuna seksuale, vepra të turpshme dhe ngacmimi seksual.

**Krime në fushën e drogës:** Përshihen vepra si prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike, trafiku i narkotikëve.

**Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor** i referohet nenit 290 të Kodit Penal.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara dhe autorët janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.